



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR TË SHOQATËS PËR  
INTEGRIMIN E ZONAVE INFORMALE PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 25.06.2019 me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Shoqatës për Integrimin e Zonave Informale për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 30 qershor, 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

**V Ë R E N**

Shoqata për Integrimin e Zonave Informale ka si qëllim të kontribuojë në forcimin e demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve në nevojë të popullsisë.



**Nr.860 i Vendimit**

**Data 25.06.2019**

**Ora 13 .<sup>00</sup> e Vendimit**

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Shoqatës për Integrimin e Zonave Informale për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 30 qershor, 2019

Prej vitesh tashmë SHIZI ka qenë aktive në një ndër proceset më fuqizuese të qytetarëve, siç janë zgjedhjet përmes projekteve edukuese, nxitëse të pjesëmarrjes dhe monitorimit të procesit zgjedhor.

Kjo organizatë ka paraqitur kërkesën e saj bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 461 (katërqind e gjashtëdhjetë e një) vëzhguesve afatshkurtër. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 e Kodit Zgjedhor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se ai është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 4 të Udhëzimit nr.13 datë 22.04.2009 të KQZ "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave".

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

### **V E N D O S I :**

- 1- Të miratojë kërkesën e Shoqatës për Integrimin e Zonave Informale për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore 30 qershor, 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.2, Model 02-LV, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 3- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI -</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr.860 i Vendimit**

**Data 25.06.2019**

**Ora 13 .<sup>00</sup> e Vendimit**

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Shoqatës për Integrimin e Zonave Informale për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 30 qershor, 2019



**Nr.860 i Vendimit**

**Data 25.06.2019**

**Ora 13 .<sup>00</sup> e Vendimit**

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Shoqatës për Integrimin e Zonave Informale për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 30 qershor, 2019